PROCESVERBALI

nga mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit Komunal të Graçanicës

e mbajtur më datën 24.01.2019 në sallën e Kuvendit Komunal të Graçanicës dhe filloi me punë në ora 10:00.

Kyesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq, hapi mbledhjen duke përshëndetur asamblistët e Kuvendit Komunal, përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, OJQ=ve, kryetarin e Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq, nënkryetarin e komunës, Kabinetin e kryetarit, drejtorët e drejtorive komunale, kryesuesin e Komitetit për Komunitete dhe zyrtarët e Komunës së Graçanicës.

Kryesuesi konstatoi se, sipas evidencës së zyrtarit për Çështjet e Kuvendit, në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm gjithsej 18 asamblistë dhe ka kuorum, ndërsa mungon asamblistja Snezhana Jovanoviq.

Kryesuesi tha se për këtë mbledhje është propozuar rendi i ditës me nëntë pikë, por në mbledhjen e sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa arriti rekomandimi se rendi i ditës të plotësohet edhe me dy pikë:

9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për lirimin e Kishës ortodokse serbe, Dioqezën e Rashkës dhe Prizrenit, nga pagesa e taksës komunale për transaksionin e pronës, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për ndryshimin e Rregullores për kushtet e përgjithshme për parcelim, rregullat dhe procedurën e ndërtimit të objekteve dhe lëshimin e kushteve për ndërtesat nën kompetencën e komunës, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjen e Mjedisit, Dejan Jovanoviq.

Kryesuesi e dha në votim rendin e propozuar të ditës me dy pika plotësuese me numër rendor 9 dhe 10, ndërsa pika 9 Të ndryshme bëhet pika 11.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18asamblistëve "Pro", miratoi rendi i ditës si në vijim:

1.	Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën

	18.12.2018.
2.	Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së drejtorive të Komunës së Graçanicës për vitin 2018, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq.
3.	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për transparencën e Komunës së Graçanicës, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq.
4.	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për transparencën e Komunës së Graçanicës 2019-2022, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjet Kadrovike, Millosh Dimitrijeviq.
5.	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores nr..01/19/KG për ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës nr.1502/16 nga 14.03.2016 nr.2189/18 nga 16.03.2018, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq.
6.	Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2018, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq.
7.	Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2018, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq.
8.	Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018, me propozim të kryesuesit të Komitetit për Komunitete, Milaim Eminoviq.
9.	Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për lirimin e Kishës ortodokse serbe, Dioqezën e Rashkës dhe Prizrenit, nga pagesa e taksës komunale për transaksionin e pronës, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq.
10.	Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për ndryshimin e Rregullores për kushtet e përgjithshme për parcelim, rregullat dhe procedurën e ndërtimit të objekteve dhe lëshimin e kushteve për ndërtesat nën kompetencën e komunës, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjen e Mjedisit, Dejan Jovanoviq.
11.	Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 18.12.2018.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Në mbledhje është e pranishme asamblistja Snezhana Jovanoviq, gjithsej janë të pranishëm 19 asamblistë dhe ka kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së drejtorive të Komunës së Graçanicës për vitin 2018, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq.

Kryetari i Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq, tha se është më shumë se i kënaqur me atë që është bërë si dhe se të gjitha qëllimet dhe projektet e planifikuara janë realizuar. Theksoi se ai dhe Komuna e Graçanicës do të vazhdojnë të punojnë në interes të qytetarëve. „Një nga memorandumet e rëndësishme është nënshkrimi i memorandumit me MAPL-në për bashkë-financimin e ndërtesës në Llapnasellë për banim social, e njëjta ministri ka financuar edhe ndërtimin e dy ndërtesave në Llapnasellë, si dhe ndërtimin e rrugës së re prej 600 metrash në kuadër të fazës së parë të urbanizimit, e cila do të jetë prioritet në vitin 2019. Është nënshkruar një memorandum me BE-në, me të cilin Kooperativa bujqësore është pajisur me makineri dhe është vë përsëri në funksion. Mbi 900 qytetarë kaluan përmes Kabinetit të kryetarit në vitin 2018 dhe falë këtyre takimeve u zgjidhën mbi 300 probleme, sepse qëllimi ynë është që ta sjellim komunën më pranë qytetarëve tanë, të jemi servisi i tyre, t'i dëgjojmë problemet e tyre dhe të përpiqemi t'i zgjidhim ato. Në fillim të vitit 2018, Komuna e Graçanicës u dha të gjitha shkollave dru për ngrohje dhe arriti të sigurojë pajisje sportive. Një nga projektet më të mëdha që kemi arritur të përfundojmë vitin e kaluar është kopshti i ri në Uglar, janë rindërtuar shkollat në Batushë, Gushtericën e Poshtme dhe të Epërme, në Llapnasellë është përfunduar salla e edukatës fizike, ndërsa balon-sallën e re e përfitoi Gushterica e Poshtme. Në Gushetricën e Epërme është ndërtuar institucioni parashkollor, ndërsa në Llapnasellë është rindërtuar Shtëpia e kulutrës. Në Llapnasellë po ndërtohet Qendra e shkollave të mesme, me një sipërfaqe bruto prej 8,000 metrash katrorë. Ne hapëm sallën e madhe sportive në Llapnasellë dhe do të përpiqemi t'i punësojmë punëtorët e rinj në këtë qendër sportive. Graçanica e përfitoi një rrugë të re primare, është ndërtuar rruga nga Batusha deri te Vragollia prej 1500 metrash, plotësisht është ndërtuar pjesa e rrugës nga Livagja deri te autostrada Prishtinë-Shkup prej 2400 metrash, në Dobrotin janë ndërtuar urat, të cilat u shkatërruan për shkak të përmbytjeve që goditën këtë fshat, është asfaltuar rruga për varrezat e reja në Graçanicë, janë shtruar me asfalt rrugët e shumta në pothuajse të gjitha vendet në Komunën e Graçanicës. Shërbimet publike ishin në kulmin e kyerjes së detyrave, rregullisht e kanë pastruar borën dhe i kanë mirëmbajtur rrugët gjatë periudhës së dimrit dhe i kanë zgjidhur problemet komunale. Sa i përket Shëndetësisë, kemi pasur një projekt të madh kapital, i cili është digjitalizimi i Kabinetit të Radiologjisë, përveç kësaj me pajisje laboratorike janë pajisur me institucionet shëndetësore, janë blerë reagenset dhe materiali shpenzues mjekësor. Për familjet në nevojë dhe çiftet e reja ne ofrojmë një çati mbi kokat e tyre falë banesave në Suhodoll. Në Gushtericën e Poshtme kemi ndërtuar tri ndërtesa, në Llapnasellë gjashtë ndërtesa, katër prej të cilave janë të ndërtuara me fondet e Komunës së Graçanicës, ndërsa dy ndërtohen nga MAPL, në bazë të memorandumit të nënshkruar. Janë

ndërtuar edhe tri shtëpi, në të cilat u rivendosën familjet më të rrezikuara sociale, ndërsa një numër i madh i familjeve morën material ndërtimor për adaptimin e hapësirave banesore.

Asamblistja Zorica Nedeljkoviq, para partisë "SRPSKA", mirëpriti raportin e kryetarit të komunës dhe gjithçka që është bërë, por kërkoi që në raportin e ardhshëm të përfshihej edhe vendbanimi Badovci i Ri me ndonjë projekt të realizuar. Badovc i Ri ka probleme me legalizimin e shtëpive, i cili ekziston që rreth 28 vjet dhe ka shtëpi që duhet të rinovohen dhe shpreson se komisioni do t'ua ndajë material ndërtimor familjeve që i nevojiten. Ajo kërkoi hapjen e një linjë të autobusëve në relacionin Badovci i Ri, Sushicë dhe vendet përreth në drejtim të Graçanicës.

Asamlisti Ratko Pereniq, para partisë "SRPSKA", gjithashtu e mirëpriti raportin e kryetarit të komunës, por kërkoi nga ai që në punën e tij në vazhdim të përqëndrohet tek rinia, krijimin e vendeve të reja të punës dhe parandalimin e largimit të të rinjve në të ardhmen.

Kryetari i Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq, u përgjigj se ai e di se problemi i punësimit dhe mbajtjes së stafit të rinj është një problem i madh që daton që një kohë të gjatë. Po punohet në mënyrë aktive në zgjidhjen e këtij problemi, i cili nuk varet vetëm nga komuna, sepse është ende në fuqi ndalimi i punësimit nga pushteti qendror, ndërsa tërheqja e investitorëve është shumë e kërkuar.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", tha ka rezultate, por ata prisnin shumë më tepër dhe se të gjithë ishin njësoj fajtorë për këtë. Meqenëse, ky është viti i parë i kryetarit të komunës me stafin që e ka trashëguar, unë me siguri do ta mbështes raportin e kryetarit të komunës. Mendoj se fondet e ndara nga Komuna e Graçanicës për të organizuar shënimin e Vitit të Ri ortodoks janë të larta dhe nëse unë do isha e pranishme në seancën e fundit do të votoja kundër. Ajo paraqiti një vërejtje dhe atë se në Kishnicë, vendi ku jeton, i jepet më shumë rëndësi komunitetit shqiptar se sa serb. Si përfaqësuese e KLSP-së për Kishnicë, Sushicë dhe Badovc, personalisht sigurova rreth 25,000 dollarë për video-mbikëqyrjen më të mirë, që përfshin një pjesë të Graçanicës, Badovcit dhe Sushicës.

Kryetari i Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq, u përgjigj se kishin bërë plane për të përmirësuar punën e drejtorive për vitin 2019, dhe çdo propozim për përmirësimin e gabimeve është i mirëpritur. Sa i përket ndarjes së fondeve për shënimin ee Vitit të Ri ortodoks, unë doja që gjithçka të bëhet transparente, dhe ky ishte festimi më i lirë deri më tani dhe mendoj se fëmijët tanë duhet ta presin çdo Vit të Ri me sa më shumë përmbajtje që është e mundur.

Asamblistja Millena Zdravkoviq, para partisë "SLS", tha se një nga prioritetet e Komunës së Graçanicës duhet të jetë vënia në funksion të transportit urban dhe zgjidhja e problemeve komunale. Gjithashtu, duhet të merren parasysh edhe njerëzit e moshuar, sepse nuk ekziston një qendër për tubimin e këtyre njerëzve.

Kryetari i Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq, tha se Komuna e Graçanicës ka filluar procesin e krijimit të një ndërmarrjeje komunale, në kuadër së cilës duhet të funksionojë edhe linja e transportit urban. Së bashku me ministrinë, ata punuan për betonimin e pjesës së poshtme të shtratit të lumit në Graçanicë, nga ura e verdhë deri te Qendra tregtare. Meqenëse shtëpia e vetme e pensionistëve ekziston në Dobrotin, do të shohim se si mund t'i caktojmë një hapësirë atyre, por do të duhet të organizohen edhe disa aktivitete për ta. Edhe këtë vit po planifikojmë të ndërtojmë një Qendër Rinore në Graçanicë, ndërsa fondet janë siguruar nga IOM.

Alleksandar Mihajlloviq, drejtor i Drejtorisë për Zhvillimin Ekonomik dhe Intergrimet, tha se në fund të vitit të kaluar ata bënë një projekt në lidhje me transportin urban, i cili është shumë i domosdoshëm, por duhet të jetë rreth 1.750.000 euro, për 5 linja dhe 10 autobusa, për të përmbushur disa kushte të përcaktuara nga niveli qendror i qeverisjes.

Asamblisti Imri Ajeti, para partisë "IQ e shqiptarëve", falënderoi kryetarin e Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq, dhe kabinetin e tij për mbështetjen e tyre deri më tani, dhe shpreson se disa nga projektet në vendin Kishnicë, Sushicë dhe Suhadoll, me të cilat është i njoftuar kryetari, do të realizohen.

Asamblisti Nebojsha Markoviq, para partisë "SRPSKA", e vlerësoi raportin e kryetarit për punën e drejtorive komunale. Në raport te projektet kapitale nuk është përmendur se Komuna e Graçanicës në Çagllavicë ka ndërtuar një rrugë, rrjetin e kanalizimit dhe ndriçimin rrugor, me të cilin është përfituar siguria, për shkak se shoferët nuk kanë nevojë të dalin në autostradë dhe për këtë arsye ai e lavdëroi drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Vladica Trajkoviq.

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", së pari falënderoi përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, EULEX-it, OJQ-ve, të cilët në vitin e kaluar i kanë ndjekur rregullisht mbledhjet e Kuvendin, si dhe drejtorët e drejtorive komunale, duke ia dëshiruar atyre të gjitha të mirat në Vitin e Ri dhe se ata duhet të jenë jo më pak se në vitin e kaluar me ne. "Z. Popoviq, ardhja juaj si kryetar i komunës së Graçanicës ishte e sigurt që ju nuk do të jetë në gjendje për të përballuar me përgjegjësitë dhe problemet. Do të kthehet në zhargonin sportiv, trajneri ndryshoi ekipi filloi të luajë. Në vitin e kaluar kanë krijuar një sistem, gjërat që janë futur në një koordinuar dhe një mënyrë e mirë për të punuar, dhe që të gjithë ne e shohim në terren. Duke analizuar vitin tuaj të suksesshme, unë besoj se komuna u bë shërbimi ligjor i qytetarëve dhe e vetmja mënyrë për të vazhduar. "I nderuar z. Popoviq, me ardhjen tuaj në pozitën e kryetarit të komunës, isha pak në dyshime se nuk do të jeni në gjendje të përballeni me detyrimet dhe problemet. Por, ju këtë e demantuat. Do t'ju drejtohem me zhargon sportiv, trajneri ka ndryshuar dhe ekipi filloi të luajë. Në këtë vit, ju keni krijuar një sistem, ju keni vënë ekipin në një mënyrë të koordinuar dhe të mirë të punës dhe ne të gjithë e vërejnë këtë në terren. Duke analizuar vitin tuaj të suksesshëm, mendoj se komuna është shndërruar në një servis të vërtetë për qytetarët dhe vazhdoni ta bëni këtë".

Kryetari i Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq, tha: "Komuna e Graçanicës do të përpiqet të vazhdojë me këtë ritëm. I falënderoj të gjithë për bashkëpunimin konstruktiv dhe shpresoj që do të vazhdohet edhe më tutje. Nëse jemi unik, besoj se do t'i arrijmë qëllimet tona".

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", e lavdëroi punën e kryetarit të Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq, kabinetit të tij, si dhe punën e shërbimit të Kuvendit dhe shumicës së drejtorive. Për periudhën e ardhshme, ai kërkoi përmirësimin e procedurës së përgatitjes së prezantimit të buxhetit dhe të gjindetmënyra për përfshirjen sa të madhe të qytetarë në këto debata publike dhe të dëgjohen propozimet e tyre reale.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi dha një pauzë prej 5 minutësh.

Pas pauzës, kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për transparencën e Komunës së Graçanicës, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Srgjan Popoviq.

Kryesuesi e ftoi zyrtarin për Informimin Publik, Nebojsha Qirkoviq, për të shpjeguar pikën e tretë dhe të katërt të rendit të ditës, si përfaqësues i autorizuar.

Nebojsha Qirkoviq, zyrtar për Informimin Publik, tha se Rregullorja për transparencën e Komunës së Graçanicës synon të përmirësojë transparencën e punës së Komunës së Graçanicës dhe pjesëmarrjen më të madhe të publikut në vendimmarrje dhe zbatimin e vendimeve të autoriteteve komunale. Disa prej dispozitave kryesore të kësaj rregulloreje janë: që për çdo vit kalendarik komuna të mbajë së paku dy takime publike për çështje me interes publik, në të cilat mund të marr pjesë çdo person apo organizatë. Përveç këtyre dy mbledhjeve, Komuna organizon takime që lidhen me planifikimin e buxhetit, planifikim hapësinor dhe planet e tjera me interes të përgjithshëm. Aktet e autoriteteve komunale që janë në interes të qytetarëve diskutohen në dëgjime publike para miratimit, duke përfshirë organizimin e debateve në vendet e komunës. Të gjitha vendimet, rregulloret, politikat dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës publikohen pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria kompetente e Pushtetit Lokal në faqen zyrtare të komunës.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", tha se Komuna e Graçanicës nuk është transparente deri në fund. Ajo vuri në dukje se konkursi i fundit për dhënien e subvencioneve për shënimin e Vitit të Ri ortodoks u botua vetëm në faqen zyrtare të komunës, ndërsa në ueb-faqen tjetër nuk ishte dhe sa i përket informacioneve në fjalë, aty komuna duhet të jetë shumë më transparente.

Nebojsha Qirkoviq, zyrtar për Informimin Publik, u përgjigj se gjithçka punohet në bazë të Rregullores, ndërsa ueb-faqja tjetër, të cilën e përmendi asamblistja Jovanoviq, është ueb-faqe private. Të gjitha thirrjet dhe konkurset janë të publikuara në ueb-faqen zyrtare, siç parashihet me Rregulloren.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", kishte një vërejtje se komuna duhet t'i ftojë mediat, dhe jo vetëm t'i njoftojë. Kam një ndjenje se vetëm Radio Graçanica është mediumi juaj personal dhe se vetëm ata kanë informacione dhe marrin thirrje.

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", pyeti: "Cilat janë mundësitë teknike që Kuvendi të marr faqen në Facebook, në mënyrë që aktet dhe aktivitetet e Kuvendit të jenë të qasshme për qytetarët, si dhe aktivitetet e Këshillave lokale?"

Nebojsha Qirkoviq, zyrtar për Informimin Publik, u përgjigj se në kuadër të Facebook-ut të komunës mund të hapet një faqe e re që do të ishte e ndarë për Kuvendin.

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", në lidhje me mediat, tha se disa media i përdorin "*spinat*", dhe se ai personalisht e ndjeu atë. Mediat që marrin fonde nga Serbia, siç është Radio Graçanica dhe të gjitha mediat e tjera janë të natyrës private, dhe në qoftë se ata nuk kanë asnjë përfitim ekonomik, unë kam frikë që ata nuk do të jenë të sinqerta dhe nuk do ta japin me ndershmëri qëndrimin e tyre. Ai paraqiti shembullin se ka emisione që shkojnë çdo javë, por nuk e kanë ftuar askënd nga Kuvendi për të shpjeguar se çfarë kemi bërë apo çka kena bërë në periudhën e mëparshme. Lajmi për caktimin e mbledhjes së sotme është plasuar një javë më parë në ueb-faqen e komunës dhe Facebook faqen e komunës, dhe tani asnjë nga mediat nuk kanë ardhur, edhe pse prita që do të jenë këtu për shkak të raportimit të kryetarit të Komunës së Graçanicës.

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", tha se këtë vit për herë të parë nuk është publikuar lajmi në ueb-faqen e komunës për një manifestim për të cilin Komuna e Graçanicës ka qenë sponsore e përgjithshme.

Nebojsha Qirkoviq, zyrtar për Informimin Publik, u përgjigj se ky është një lëshim edhe pse ai ishte i pranishëm në atë ngjarje.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për transparencën e Komunës së Graçanicës 2019-2022, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjet Kadrovike, Millosh Dimitrijeviq.

Nebojsha Qirkoviq, zyrtar për Informimin Publik, tha se Plani i veprimit për transparencë paraqet një plan për aktivitetet e Komunës së Graçanicës për një periudhë katër vjeçare në fushën e transparencës, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarjes dhe mbikëqyrjes së punës së organeve komunale.

Asamblistja Millena Zdravkoviq, para partisë "SLS", tha se gjuha rome është gjuhë në përdorim zyrtar në Komunën e Graçanicës dhe pyeti a ka Komuna e Graçanicës kapacitete për të ofruar shërbime për komunitetin rom.

Nebojsha Qirkoviq, zyrtar për Informimin Publik, u përgjigj se nuk ka, sepse komuna në disa raste ka kërkuar aprovimin e vendit të punës për punësimin e përkthyesin të gjuhës rome, por për fat të keq fondet nuk u gjetën

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", tha se më parë ishin dy përkthyes në gjuhën rome, të cilët kishin kaluar nëpër trajnime dhe kishin punuar për një kohë në komunë, por fatkeqësisht Ministria e Financave nuk i ka aprovuar mjetet për këto dy përkthyes dhe nuk lejon që Komuna e Graçanicës të rrisë numrin e punëtorëve.

Asamblistja Millena Zdravkoviq, para partisë "SLS", sugjeroi që komuniteti rom të përfshihet në punën praktike e cila po realizohet çdo vit në Komunën e Graçanicës, në mënyrë që të ofrohen shërbime për komunitetin e tyre. Ajo u pajtua me asamblistën Jovanoviq që nuk është gjithçka transparente dhe u pajtua edhe me çështjen e mediave. Ajo shtoi se ekziston një kërkesë e paraqitur në Komunën e Graçanicës, përmes së cilës kërkohen informatat për takimet publike, si dhe procesverbalet nga këto takime, lidhur me pikën "Ndryshimi i linjave kadastrale në mes të komunave të Fushë Kosovës dhe Komunës së Graçanicës" kur ne nuk votuam.

Nebojsha Qirkoviq, zyrtar për Informimin Publik, u përgjigj se një nga detyrimet e tij është edhe qasja në dokumente publike, dhe këtë kërkesë unë nuk e mora. Afati i fundit për t'iu përgjigjur një kërkese është 7 ditë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores nr.01/19/KG për ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës nr.1502/16 nga 14.03.2016 nr.2189/18 nga 16.03.2018, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq.

Kryesuesi sqaroi se në Rregulloren e punës, neni 30 paragrafi 4, ku thuhet: "Plani i veprimit të transparencës, pas miratimit nga Kuvendi Komunal, do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës". Rregullorja e Kuvendit Komunal të Graçanicës në pjesën e mbetur mbetet e pandryshuar.

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", tha se ka kërkuar që në të ardhmen, kur në mbledhjet do të diskutohet ndonjë ndryshim në një rregullore, t'ua paraqisnin rregulloren e plotë me ndryshimet që janë bërë, si dhe një propozim për ndryshim.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2018, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq.

Kryesuesi tha se në vitin 2018, MAPL-ja i ktheu vetëm një vendim Kuvendit si të paligjshëm, bëhet fjalë për vendimin për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në përbërje prej 11 anëtarësh. Vendimi u kthye për rishqyrtim dhe Kuvendi themeloi një Komitet me 5 anëtarë, siç parashihet me Udhëzimin administrativ, ndërsa përbërja tani pasqyron përfaqësimin e të pesë subjekteve politike në Kuvend. Gjatë vitit 2018, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 9 mbledhje të rregullta dhe 4 të jashtëzakonshme.

Asamblisti Goran Millenkoviq, para partisë "IQ Fillimi i Ri", kishte një vërejtje dhe atë se në raportin tek prezantimet publike në vitin 2018, thuhet se në të gjitha gjashtë prezantimet morën pjesë asamblistët dhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, por unë personalisht nuk isha i ftuar për të marr pjesë në këto prezantime publike.

Kryesuesi u përgjigj se ai, si kryesues, ishte prezent në të gjitha prezantimet publike, ndërsa disa asamblistë ishin të pranishëm në vendet ku ata jetojnë. Sigurisht që është dashur t'i ftojmë individualisht çdo asamblistë për të marr pjesë në këto prezantime, edhe pse ne mendojmë se në biseda informale e bëmë këtë dhe problemi tjetër është se një numër i vogël i qytetarëve ndoqën prezantimet.

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", tha se vitin e kaluar para mbajtjes së prezantimeve buxhetore, në seancën e Kuvendit, ai ua sugjeroi kolegëve të marrin pjesë në prezantimin e buxhetit. Gjatë vitit 2018, Komiteti për Politikë dhe Financa punoi shumë në mënyrë transparente dhe të gjitha informatat ishin në dispozicion të tyre. Dëshiroj ta falënderoj Shërbimin e Informimit Publik, Shërbimin për Çështjet e Kuvendit dhe Shërbimin e përkthimit në punën profesionale, dhe të vazhdojnë kështu edhe këtë vit, në mënyrë transparente në komunikim dhe bashkëpunim me të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike. Në mandatin e mëparshëm, shumë vendime u kthyen nga MAPL, dhe në këtë përmbajtje të Kuvendit kjo nuk po tregohet si praktikë, falë kryesuesit të Kuvendit së bashku me stafin që është rreth tij.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2018, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq.

Kryesuesi nga raporti veçoi faktin se në vitin 2018 Kuvendi ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta dhe 4 të jashtëzakonshme dhe 1 seancë solemne. Përbërja e subjekteve politike, pas formimit të Kuvendit Komunal, numëron 12 asamblistë të "SRPSKËS", 3 asamblistë të SLS-së, 2 asamblistë të PDS-së, 1 asamblist të IQ Fillimi i Ri dhe 1 asamblist i IQ të shqiptarëve. Gjatë vitit ka pasur një ndryshim, sepse një asamblist nga subjekti politik SLS, ka kaluar te Srpska, e cila tani numëron 13 asamblistë të Kuvendit. Në mbledhjet e Kuvendit, janë miratuar gjithsej 82 akte, prej të cilave, 74 vendime, 5 rregullore, Plani i punës së Kuvendit për vitin 2019, Plani i veprimit mbi transparencën e Komunës së Graçanicës për vitin 2018, dhe Rregullorja e punës së Kuvendit. Në planin vjetor të punës të Kuvendit për vitin 2018, janë parashikuar 59 pika për rendin e ditës, nga të cilat: 37 janë shqyrtuar. Në afatin ligjor, të gjitha aktet e miratuara në mbledhjet e Kuvendit i janë dërguar MAPL-së për vlerësimin e ligjshmërisë dhe të gjitha aktet janë publikuar në faqen e internetit të komunës. MAPL ka vlerësuar se 21 akte prodhojnë efekte ligjore, ndërsa akti për formimin e Komitetit të Politikave dhe Financave është rishqyrtuar. Kuvendi ka ndryshuar aktin dhe përbërjen e komitetit, pra nga 11 është zvogëluar numri i tyre në 5 anëtarë, në përputhje me Udhëzimin administrativ të MAPL-së. Gjatë vitit 2018, Kuvendi formoi dy komitete: Komitetin e Shërbimeve Publike (gjatë vitit 2018 ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta) dhe Komitetin për Personat me Aftësi të Kufizuara. Kuvendi në shtator 2018 mbajti gjashtë prezantime publike të buxhetit për vitin 2019 dhe atë në: Uglar, Lepinë, Gushtericën e Poshtme, Llapnasellë, Kishnicë dhe Graçanicë.

Asamblistja Jellena Dimitrijeviq, para partisë "SRPSKA", tha se në raportin tek prezantimet publike theksohet se qytetarët nga secili vend kanë kërkuar diçka, përveç të atyre në Graçanicë. Kam marrë pjesë në këtë prezantim së bashku me dy këshilltarë të tjerë dhe e di që kemi kërkuar shumë projekte si dhe qytetarët që morën pjesë.

Asamblisti Millan Dimitrijeviq, para partisë "SRPSKA", u pajtua me pyetjen e asamblistës Jellena Dimitrijeviq, sepse ai ishte i pranishëm në atë prezantim.

Kryesuesi tha se është padyshim një lëshim i paqëllimtë, por sigurisht që të gjitha problemet e paraqitura në prezantimet publike janë regjistruar dhe mund të iniciohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe leht mund të trajtohen nga drejtori përgjegjës siç është Vladica Trajkoviq. Ai kërkoi nga asamblistët e Kuvendit të kenë mirëkuptim në periudhën e ardhshme, sepse çdo fjali nuk mund të vihet në procesverbal, sepse nuk bëhet transkriptimi, përveç nëse ndonjë fjali e asamblistit është shkruar keq dhe e ka humbur kuptimin.

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", tha se prezantimet publike nuk duhej të gjendeshin në raportin vjetor të punës, sepse buxheti u miratua dhe çfarë lidhje ka të bëjë kjo me punën e Kuvendit.

Asamblisti Radovan Filliq, para partisë "SRPSKA", kërkoi që kryesuesi i Kuvendit, në mbledhjet e ardhshme të vendosë matjen e kohës së deklaratave të asamblistëve të Kuvendit, në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, me qëllim që puna e Kuvendit të bëhet më efektive, pasi shpesh dëgjojmë deklarime tepër të gjera nga të cilat shpesh nuk kemi asnjë dobi.

Asamblistja Zorica Nedeljkoviq, para partisë "SRPSKA", tha se në raport përmendet që është formuar Komiteti për persona me nevoja të veçanta, por që nga data e formimit, ne ende nuk kemi ndonjë informacion shtesë lidhur me punën e këtij komiteti. Ajo u pajtua me asamblistin Filliq, i cili kërkoi të kufizohet deklarimi i të gjithë asamblistëve.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e shtatë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2018, me propozim të kryesuesit të Komitetit për Komunitete, Milaim Eminoviq.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Milaim Eminoviq, tha se gjatë vitit 2018 janë mbajtur 12 mbledhje të rregullta dhe 1 e jashtëzakonshme, në të cilën morën pjesë përfaqësuesit e KFOR-it „LMT", OSBE-së, UNMIK-ut, me të cilët kam një bashkëpunim të shkëlqyer, si dhe përfaqësuesit e OJQ-ve dhe publiku, ku në një nga mbledhjet ishte i pranishëm edhe komandanti i stacionit policor në Graçanicë, si dhe zëvendësi i tij. Në mbledhje u diskutuan problemet e infrastrukturës, ndërsa përfaqësuesit e komuniteteve paraqitën problemet specifike në komunitetet e tyre. Pjesëtarët e komuniteteve pakicë janë gjithashtu edhe anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe kërkuan mbajtjen e rregullt të KKSB-së, për shkak se vitin e kaluar janë mbajtur vetëm dy mbledhje në vit, ndërsa sipas Udhëzimit administrativ duhet të mbahen minimum gjashtë mbledhje.

Asamblisti Imer Ajeti, para partisë "IQ e shqiptarëve", tha se ka një bashkëpunim të dobët me z. Eminoviq, kryesuesin e Komitetit për Komunitete. Ai tha se përmes Zyrës për Komunitete dhe Kthim janë punësuar gjashtë përfaqësues të komunitetit RAE dhe mendon se ky informacion duhet të jetë i përfshirë në Raportin vjetor të punës së Komitetit. Ai e falënderoi trafikut urban "Trafik Urban", i cili i punësoi gjithsej 12 përfaqësues të komunitetit RAE, nga të cilët gjashtë janë nga Komuna e Graçanicës. Në raport gjithashtu mungojnë të dhënat për dy familje shqiptare dhe atë të Syla Kelmendit nga Sushica dhe tjetra nga Kishnica të Raza Gashit, të cilat jetojnë në kushte të vështira.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Milaim Eminoviq, tha se në Komitetin për Komunitete komuniteti shqiptar ka një përfaqësues, i cili është Fehmi Arifi, i cili nuk e ka paraqitur problemin për këto dy familje shqiptare. Ai mund të ketë paraqitur kërkesën me shkrim në komunë tek shërbimi kompetent, por ai sigurisht do ta kontrollojë këtë dhe do ta korrigjojë gabimin. Sigurisht do ta marrim në konsideratë këtë kërkesë për këto dy familje.

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", e pyeti Eminoviqin nëse punësimi i pjesëtarëve të komunitetit RAE ka shkuar përmes Komitetit për Komunitete dhe çfarë bashkëpunim ka me z. Arifi, i cili është përfaqësues i komunitetit shqiptar në këtë komitet.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Milaim Eminoviq, u përgjigj se punësimi nuk ka shkuar përmes komitetit. Kam një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Arifin, i cili ishte i rregullt në të gjitha mbledhjet, ku mori pjesë dhe diskutoi.

Asamblisti Vidak Ristoviq, para partisë "PDS", tha se pasi që punësimi nuk ka shkuar përmes komitetit, atëherë kjo nuk duhet të jetë e përfshirë në raportin e komitetit. Ai tha se para formimit të Komitetit për Komunitete, ai propozoi që asamblisti Imri Ajeti duhet të jetë në këtë komitet, sepse do të ishte shumë më leht zgjidhja e problemeve në qoftë se z. Ajeti si zëvendëskryesues i Kuvendit do të ishte në këtë komitet. Ai i sugjeroi z. Eminoviq që në të ardhmen në mbledhjet e komitetit të ftohet kryesuesi i Kuvendit dhe zëvendëskryesuesi z. Ajeti. "Unë do t'ju kisha emëruar z. Eminoviq si nënkryetarin për komunitetet pakicë, por do t'ju sugjeroja që të bashkëpunoni me Zyrën për Komunitete dhe Kthim dhe zëvendëskryesuesin e Kuvendit, z. Ajeti, sepse unë mendoj se ju jeni të arsimuar mirë dhe kjo është hera e parë që ne kemi këtë një raport gjithëpërfshirës, të saktë dhe të qartë nga komiteti".

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e tetë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për lirimin e Kishës ortodokse serbe, Dioqezën e Rashkës dhe Prizrenit, nga pagesa e taksës komunale për transaksionin e pronës, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Ljubisha Karaxhiq.

Kryesuesi sqaroi se përbërja e mëparshme e Kuvendit mori vendim për lirimin e komuniteteve fetare nga pagesa e taksave komunale, por Drejtoria e Financave kërkoi një vendim të posaçëm të Kuvendit për lirimin e Kishës ortodokse serbe, Dioqezës së Rashkës e Prizrenit nga pagesa e taksës komunale për transaksionin e pronës për pesë parcelat e specifikuara në kërkesë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e nëntë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për ndryshimin e Rregullores për kushtet e përgjithshme për parcelim, rregullat dhe procedurën e ndërtimit të objekteve dhe lëshimin e kushteve për ndërtesat nën kompetencën e komunës, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjen e Mjedisit, Dejan Jovanoviq.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e dhjetë të rendit të ditës.

Asamblisti Zoran Mitroviq mungon nga mbledhja, në mbledhje janë të pranishëm 18 asamblistë dhe ka kuorum.

Bojan Stojanoviq, jurist nga Drejtoria e Urbanizmit, shpjegoi se Kuvendi miratoi Rregulloren për parcelim, rregullat dhe procedurën e ndërtimit të objekteve dhe lëshimin e kushteve ndërtimore për ndërtesat nën kompetencën e komunës në mbledhjen e mbajtur më 26.09.2018. Pas hyrjes në fuqi të rregullores janë vërejtur disa vështirësi në zbatimin e neneve 51, 52, 62, 63 dhe 64, që kanë të bëjnë me ndarjen dhe bashkimin e parcelave dhe për këtë është e nevojshme të bëhet plani rregullues i detajuar. Planet rregulluese të detajuara punohen kryesisht për zonat e pandërtuara dhe mbulojnë një zonë pak më të madhe, ndërsa procedura e miratimit të planeve rregulluese të detajuara paraqet një procedurë komplekse që zgjat të paktën 6 muaj dhe kërkon burime të mëdha financiare. Ne patëm një situatë ku Drejtoria e Kadastrës nuk ka mundur të funksiononte, përkatësisht nuk ishte në gjendje t'i kryente ndarjet dhe bashkimin e parcelave.

Asamblisti Millan Dimitrijeviq, para partisë "SRPSKA", pyeti pse para miratimit të rregullores nuk është marr parasysh zbatimi i këtyre neneve. Ai shprehu pakënaqësi që Drejtoria e Urbanizmit, që nga fillimi i punës së kësaj përbërjeje të Kuvendit, i dorëzon një minutë deri në orën 12:00 propozimet për ndryshimin e rendit të ditës dhe vetëm dy herë i ka parashtruar propozimet me kohë.

Kryesuesi shpjegoi se për mbledhjet e rregullta të Kuvendit, propozuesit, sipas ligjit, Statutit dhe Rregullores së punës së Kuvendit, kanë të drejtë ta paraqesin kërkesën për plotësimin e rendit të ditës, ndërsa asamblisti i Kuvendit vendosin a do të aprovohet apo refuzohet kërkesa për plotësimin e rendit të ditës. Sa i përket mbledhjeve të jashtëzakonshme, të gjitha pikat e parapara me rendin e ditës nuk mund të ndryshohen në atë mbledhje.

Bojan Stojanoviq, jurist nga Drejtoria e Urbanizmit, u përgjigj se gjatë përgatitjes së kësaj rregulloreje kemi konsideruar se nuk do të ketë probleme të mëdha, por gjatë zbatimit të rregullores ka pasur probleme që nuk kanë mundur të parashikohen paraprakisht. Lidhur me paraqitjen e propozimit për ndryshimin e rendit të ditës, ai shtoi se kjo pyetje duhet t'i drejtohet drejtorit të Urbanizmit.

Asamblistja Jellena Dimitrijeviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se çfarë saktësisht parashesin këto nene, të cilët duhet të fshihen.

Bojan Stojanoviq, jurist nga Drejtoria e Urbanizmit, tha se këto nene parashesin: Neni 51 "Parcela ndërtimore mund të ndahet me parcelim vetëm sipas planit të rregullimit të detajuar apo me bartjen e pronësisë tek personi tjetër në mënyrë të paraparë me ligj, por jo nën minimumin e paraparë me këtë Rregullore". Neni 52 "Parcela ndërtimore mund të rritet me parcelim vetëm sipas planit të rregullimit të detajuar apo me bartjen e pronësisë tek personi tjetër në mënyrë të paraparë me ligj". Neni 62 "Ndalohet (përveç në rastet e ndarjes fizike, me rastin e zbatimit të aktvendimit për trashëgimin, dhurimin dhe bartjen e pronësisë tek personi tjetër, mbi një bazë tjetër) çfarëdo ndarje, zvogëlimi dhe parcelimi i tokës bujqësore". Neni 63 parasheh se për ndarjen e parcelës duhet të ekzistojë pëlqimi i Urbanizmit, ndërsa Urbanizmi nuk mund ta jep këtë pëlqim, sepse parcelimi duhet të bëhet në bazë të planit të detajuar rregullues, i cili nuk ekziston. Neni 64 "Çfarëdo ndryshim i tokës bujqësore, në aspektin e ndryshimit të sipërfaqes (ndarja fizike/parcelimi), si dhe ndryshimi i kulturës së tokës, Drejtoria e Kadastrës nuk mund të bëjë pa pëlqimin e dhënë nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjen e Mjedisit, të lëshuar në emër të parashtruesit të kërkesës për kryerjen e ndryshimit të lartpërmendur".

Asamblisti Radovan Filliq, para partisë "SRPSKA", pyeti: "A e keni ditur se nuk keni plan të detajuar kur e keni paraqitur rregulloren për miratim?"

Bojan Stojanoviq, jurist nga Drejtoria e Urbanizmit, u përgjigj se e kanë ditur, por ai nuk është i vetmi që ka marr pjesë në hartimin e rregullores.

Asamblisti Ivan Saviq, para partisë "SRPSKA", kërkoi shpjegim për nenin 64 të rregullores.

Bojan Stojanoviq, jurist nga Drejtoria e Urbanizmit, e sqaroi nenin 64 me një shembull dhe atë nëse pronari posedon një parcelë prej 50 arë tokë, ndërsa ka 5 djem dhe dëshiron t'ua japë atyre nga 10 arë tokë, kjo nuk mund të bëhet në Kadastër pa pëlqimin e Urbanizmit, gjë që nuk ka kuptim.

Asamblisti Radovan Filliq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kur e kanë vërejtur se kjo paraqet problem real.

Bojan Stojanoviq, jurist nga Drejtoria e Urbanizmit, u përgjigj në mes të tetorit, kur filluan të dorëzoheshin kërkesat për dhënien e pëlqimit për ndarjen e parcelave.

Asamblisti Radovan Filliq, para partisë "SRPSKA", tha se ata duhet të kishin reaguar më herët dhe jo të lejonin që Shërbimi i Kadastrës të bllokohej dhe kërkoi që të gjitha pyetjet e parashtruara nga asamblistët t'i adresohen drejtorit të Urbanizmit në mënyrë që t'i marrin përgjigjet nga ai.

Kryesuesi tha se sipas Planit të punës së Kuvendit për vitin 2019 janë paraparë aktivitetet siç janë takimet joformale me drejtorët e drejtorive komunale, ku asamblistët mund t'i parashtrojnë pyetjet drejtorëve.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendit njëzëri, me votat e 17 asamblistëve "Pro" dhe 1 "Abstenim" Goran Millenkoviq, miratoi pikën e dhjetë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Të ndyrshme.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët e Kuvendit që në bazë të pyetjeve të tyre të paraqitura në mbledhje në lidhje me rritjen e pagave, së bashku me zëvendëskryesuesin Imri Ajeti kemi zhvilluar një takim me kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK). Propozimi për rritjen e pagave për asamblistët e Kuvendit, të inicuar nga AKK-ja, është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili së shpejti do të duhet të miratojë buxhetin, por kur ai do të hyjë në fuqi ne nuk e dimë. Kryesuesi gjithashtu i informoi asamblistët se AKK-ja po organizon një seminar më 29 janar në orën 10:30, në Prishtinë, në kuadër të projektit për zhvillimin e kapaciteteve të furnizimit me ujë dhe të shërbimeve hidrosanitare përmes planifikimit për investime, dhe se asamblistët të cilët dëshirojnë të marrin pjesë duhet të lajmërohen Shërbimit të Kuvendit.

Asamblistja Millena Zdravkoviq, para partisë "SLS", tha se për çdo ditë po paraqitet nga një person që ka nevojë për ndihmë për shërim. Ajo sugjeroi që Kuvendi të organizojë një takim, ku do të thirren të gjitha institucionet përkatëse që merren me këtë dhe që kanë fonde për trajtimin e fëmijëve dhe të rriturve jashtë vendit. Në takim mund të thirren gjithashtu edhe të gjitha organizatat lokale humanitare, si dhe të ndërtohet baza e të dhënave për njerëzit që kanë nevojë për ndihmë dhe të lidhën ata me fondacionet në Kosovë, ndoshta edhe me atë të rajonit, me qëllim të bashkimit të mjeteve dhe drejtimit të tyre në adresat e duhura.

Kryesuesi tha se ky propozim është shumë i mirë, si dhe që në shkurt do të organizohet një takim, ku do të ftohet drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe organizatat joqeqveritare që merren me punë humanitare.

Asamblisti Imri Ajeti, para partisë "IQ e shqiptarëve", paraqiti problemin e banorëve të Kishnicë dhe përreth lidhur me ujin e pijshëm, problemin të cilin e ka paraqitur edhe në prezantimin e buxhetit. Problemi ka të bëjë me gypat e vjetra të ujësjellësit që shpesh pëlcasin, dhe pasi që bëhet fjalë për linjën kryesore, atëherë pa ujë mbeten edhe vendbanimi Sushica, Badovci i Ri dhe një pjesë e fshatit Lagja e Re pranë liqenit. Më e keqja është që këto gypa të ujit janë prej asbestit që është substancë kancerogjene dhe kërkoj që ky problem të zgjidhet sa më shpejtë.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë "SRPSKA", i sugjeroi asamblistës Zdravkoviq nëse ajo dëshiron të organizojë një takim lidhur me sigurimin e fondeve për trajtim, atëherë ajo duhet gjithashtu të jetë udhëheqëse e kësaj iniciative. Lidhur me problemin e paraqitur nga asamblisti Ajeti, ajo tha se me siguri problemi në fjalë është më i gjatë se 20 vjet.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja përfundoi në orën 13:27.

Procesmbajtësi:
Agron Karadollami

Kryesuesi i KK të Graçanicës
Ljubiša Karadžić